

TETRA TECH

Republika e Kosovës / Republika kosova
Komuna e Gjakovës / Opština Djakovica
Direjtorija për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-13737
Data/Datum 10.07.2023
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



Komuna e Gjakovës
Opština Đakovica-Municipality of
Gjakova/Đakovica

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NË MES TË

Tetra Tech ARD, Inc.

Zbatuesi i Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës

DHE

Komunës së Gjakovës

NË LIDHJE ME

Zbatimin e përbashkët të Aktivitetit Qeverisja e Pronës

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (“MM”) lidhet sot më 10 korrik 2023 (“data e hyrjes në fuqi”), nga dhe në mes të Tetra Tech ARD, Inc., dhe Komunës së Gjakovës, të referuar bashkërisht si “Pjesëmarrësit” dhe secili veç e veç si “Pjesëmarrësi”.

Aktiviteti Qeverisja e Pronës e ka si qëllim të bashkëpunojë me Komunën e Gjakovës për përmirësimin e sistemit për të drejtat pronësore në Kosovë në mënyrë që të ulët korrupsioni, të rritet fuqizimi i grave, si dhe të përmirësohen të drejtat formale pronësore dhe investimet në patundshmëri.

Qëllimi i Aktivitetit është të bashkëpunojë me Komunën e Gjakovës për rritjen e të drejtave formale pronësore duke i standardizuar proceset dhe praktikat në komunë;

Aktiviteti synon të bashkëpunojë me Komunën e Gjakovës për rritjen e angazhimit aktiv të shoqërisë civile dhe qytetarëve me institucionet në lidhje me të drejtat pronësore; dhe

Aktiviteti ka për qëllim të bashkëpunojë me Komunën e Gjakovës për angazhimin e sektorit privat në forcimin e regjimit për të drejtat pronësore në Kosovë.

Pjesëmarrësit synojnë të bashkëpunojnë në aktivitetet e mëposhtme:

1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është formalizimi i bashkëpunimit në mes të Tetra Tech ARD, Inc., kontraktori që zbaton Aktivitetin Qeverisja e Pronës në Kosovë të financuar nga USAID-i, dhe Komunës së Gjakovës. Duke i koordinuar ngushtë përpjekjet e Aktivitetit dhe Komunës së Gjakovës në kuadër të këtij MM, të dyja palët synojnë t’i shfrytëzojnë resurset e tyre përkatëse për të arritur rezultate të cilat nuk do të mund të arriheshin nga secili në formë individuale. Aktiviteti dhe Komuna janë të përkushtuar ndaj parimeve të qeverisjes së mirë: sundimi i ligjit, transparenca, llogaridhënia, efiçienca, efektshmëria, përgjegjshmëria, përfshirja dhe pjesëmarrja e qytetarëve. Andaj, Pjesëmarrësit e kanë nënshkruar këtë MM që të përcaktojnë veprimet e tyre të propozuara në lidhje me mbështetjen e tyre për këtë qëllim.

2. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ka kontraktuar Tetra Tech ARD, Inc., si kontraktorin kryesor për zbatimin e Aktivitetit Qeverisja e Pronës në Kosovë, me kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe me vlerë prej 10.1 milionë dollarësh amerikanë. Tetra Tech ARD, Inc., do ta zbatojë Aktivitetin gjatë periudhës pesëvjeçare nga maji 2022 deri në maj 2027. Aktiviteti synon përmirësimin e sistemit të të drejtave pronësore në Kosovë në mënyrë që të ulët korrupsioni, rritet fuqizimi i grave, si dhe të përmirësohen të drejtat formale pronësore dhe investimet në patundshmëri. Në partneritet me shoqërinë civile, sektorin privat dhe akterë të tjerë lokalë, Aktiviteti do të kontribuojë në avancimin e zhvillimit të udhëhequr nga niveli lokal.

Aktiviteti do të përqendrohet në forcimin e sistemit për të drejtat pronësore duke i përmirësuar proceset e Zyrës Kadastrale Komunale (ZKK) dhe ofrimin e shërbimeve që i duhen qytetarëve për formalizim dhe regjistrim të të drejtave të tyre. Aktiviteti do të punojë për standardizimin e procedurave administrative në mënyrë që qytetarët të stimulohen për të nisur procedurat për formalizim, si dhe që të hiqen kërkesat burokratike për regjistrim të cilat dekurajojnë qytetarët që t'i regjistrojnë të drejtat e tyre pronësore.

Rezultatet e pritura:

- Përmirësimi i kapaciteteve komunale për menaxhim të pronës;
- Përmirësimi i proceseve dhe praktikave për inspektimin e ndërtesave, të cilat do të kontribuojë në rritjen e regjistrimit të pronave (certifikatat e pronësisë) në komunat e përzgjedhura;
- Unifikimi/standardizimi i shërbimeve lidhur me pronat në komunat e përzgjedhura;
- Integrimi i barazisë gjinore në reformat për çështjet pronësore në Kosovë; dhe
- Përmirësimi i proceseve për trashëgim të pronës.

Për më tepër, Aktiviteti do të ndihmojë që të mobilizohen qytetarët për pjesëmarrje në qeverisje lokale me qëllim përmirësimin e proceseve të lidhura me pronat dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe në koordinim me Këshillat Lokal të kujdeset që këto aspekte të trajtohen në planet zhvillimore komunale (PZHK). Aktiviteti do t'u ofrojë ndihmë forumeve për transparencë pronësore të përbëra nga organizata të shoqërisë civile, sektori privat, gazetarë dhe qytetarë të interesuar, në mënyrë që t'i mbikëqyrin, monitorojnë dhe raportojnë për zbatimin e PZHK-ve. Këto intervenime, përmes ndikimit të tyre të gjithmbarshëm, do të lehtësojnë funksionimin e qasjes së përqendruar tek qytetari për qeverisjen e të drejtave pronësore, do të forcojnë marrëdhënien ndërmjet qeverisjes dhe qytetarëve, si dhe do të rrisin transparencën, llogaridhënien dhe mëvetësinë.

Rezultatet e pritura:

- Forcimi i mbikëqyrjes prej shoqërisë civile dhe qytetarëve në mënyrë që të sigurohet transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në proceset dhe shërbimet për të drejtat pronësore dhe për trashëgim të pronës;
- Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në PZHK në mënyrë që të sigurohet transparencë në shfrytëzimin e pronave dhe tokës komunale;
- Rritja e vetëdijesimit dhe avokimit për vlerën e të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e tyre ekonomike; dhe
- Rritja e të kuptuarit prej publikut të rregullave dhe rregulloreve të sektorit pronësor në mënyrë që të përmirësohet avokimi nga publiku për sigurim të qasjes në shërbime dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre pronësore.

Për fundi, Aktiviteti do të punojë në partneritet ndërmjet sektorit privat, qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për mbështetjen e reformave që do të lehtësojnë qasjen e qytetarëve në të dhënat kadastrale, do të trajtojnë kufizimet ndaj formalizimit të të drejtave të lidhura me ndërtesat e ndërtuara rishtazi, si dhe do të ndihmojnë që të demonstrohen përfitimet afariste nga pjesëmarrja e grave në ekonomi, në mënyrë që të nxitet kërkesa për iniciimin e procedurave trashëgimore. Gjithashtu, këto partneritete do të fusin në përdorim qasje inovative ndaj teknologjive të reja që do të forcojnë pjesëmarrjen e publikut dhe do të mundësojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen e sistemeve pronësore.

Rezultatet e pritura:

- Kritja e angazhimit të sektorit privat në modernizimin institucional dhe teknologjitë për automatizim të sistemeve dhe shërbimeve pronësore; dhe
- Kritja e angazhimit të sektorit privat në planet zhvillimore komunale për rregullore më transparente për të drejtat pronësore dhe nxitjen e investimeve të sektorit privat.

Fushat e Ndhmës Teknike

Aktiviteti i USAID-it, i zbatuar nga Tetra Tech ARD, Inc., synon të adresojë nevojat e Komunës së Gjakovës të identifikuar nga intervistat me stafin komunal dhe hulumtimi i përgjithshëm që do të realizohen nga Aktiviteti. Ndhma specifike e planifikuar të ofrohet nga Tetra Tech ARD, Inc., për zbatimin e Aktivitetit, specifikohet më poshtë në nenin 4.

3. ROLI I AKTIVITETIT

Aktiviteti synon ta mbështesë Komunën e Gjakovës duke u përqendruar në procesin e gjithmbarshëm të qeverisjes së pronës në Kosovë, si në vijim:

- Vlerësimi, identifikimi dhe hartimi i një raporti për komunën me rekomandime për harmonizimin e kornizës rregullatore me ligjet për regjistrimet.
- Zhvillimi i një dokumenti të politikave që përshkruan opsionet për krijimin e stimujve që i inkurajojnë qytetarët t'i regjistrojnë dhe formalizojnë të drejtat e tyre;
- Hartimi i udhëzimeve për kryerjen e inspektimeve të ndërtesave, në pajtueshmëri me ligjin, nga kompani/individë privatë të licencuar;
- Ofrimi i trajnimeve për kompani/individë privatë të licencuar bazuar në udhëzimet e aprovuara;
- Organizimi i një punëtorie teknike për Njësitë e Inspektimit (NJI) dhe Shoqatën e Ndërtimtarëve dhe Prodhuesve të Materialeve Ndërtimore (SHNPMN) ku do të hartohet plani për komunikim dhe informim për investitorët/ndërtimtarët në mënyrë që kërkesat e tyre për leje ndërtimi dhe të pranimit teknik të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Zhvillimi i modaliteteve për përcjelljen e raporteve të inspektimit për pajtueshmëri që mundësojnë regjistrimin e të drejtave pronësore;
- Hartimi i raporteve të vlerësimit të kapaciteteve teknike të Zyrave Kadastrale Komunale (ZKK) dhe raporteve të vlerësimit që identifikojnë ndonjë anshmëri në ofrimin e shërbimeve në ZKK;
- Zhvillimi i Planit për Përmirësim të Shërbimeve përmes proceseve të dizajnit në bashkëpunim me përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), stafin e ZKK-ve dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile lokale;
- Mbështetja në formimin e Forumit për Transparencë në Pronë (FTP), në koordinim me Këshillat Lokal, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim i gjerë i qytetarëve dhe akterëve të sektorit privat në monitorimin e zbatimit të Planeve Zhvillimore Komunale (PZHK);
- Organizimi i diskutimeve në grupe të fokusit (DGF) me vendimmarrësit dhe stafin komunal në mënyrë që ata të informohen dhe t'i shfrytëzojnë masat për ulje të mundësive për korrupsion në lidhje me shërbimet pronësore;

- Zhvillimi i një programi trajnimi kundër korrupsionit për ZKK-të dhe stafin tjetër komunal, në mënyrë që të ndihmohet në parandalimin e korrupsionit në lidhje me shërbimet pronësore;
- Krijimi i Forumit për Transparencë Pronësore (FTP);
- Koordinimi me FTP-në për monitorim të zbatimit të PZHK-së, në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia;

Mobilizimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin dhe monitorimin e PZHK-së;

- Mobilizimi i angazhimit të sektorit privat për përmirësimin e kornizës rregullative në mënyrë që të rritet transparenca dhe të krijohen stimuj për investime, si dhe që të inkurajohet komuna t'i përdorë teknologjitë GIS për identifikimin e tokave komunale që do të jepen me qira në përputhje me PZHK-në për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Vlerësimi i kapaciteteve të Komunës për identifikimin, përmbledhjen dhe menaxhimin e informacionit në lidhje me tokat në pronësi të komunës;
- Ndihma për komunën që të kryejë konsultime të Këshillit Publiko-Privat në mënyrë që të ndihmohen bizneset lokale t'i shprehin interesat dhe nevojat e tyre për tokë dhe që këto të përafrohen me caqet zhvillimore të PZHK-ve;
- Mbështetja e Komunës që të mobilizohet pjesëmarrja e bizneseve në përgatitjen e inventarit të tokave dhe aseteve të komunës.

4. ROLI I KOMUNËS

Synimet e Komunës janë:

- Aprovimi dhe zbatimi i rekomandimeve për harmonizimin e kornizës rregullative komunale me ligjet për regjistrime;
- Aprovimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të stimujve të rekomanduar në mënyrë që të inkurajohen qytetarët që t'i regjistrojnë dhe formalizojnë të drejtat e tyre;
- Zbatimi i udhëzimeve për kryerjen e inspektimeve të ndërtesave, në pajtueshmëri me ligjin, nga kompani/individë privatë të licencuar;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së stafit komunal në punëtori, trajnime, diskutime në grupe të fokusit dhe aktivitete të tjera të ofruara nga Aktiviteti dhe nënkontraktorët e tij;
- Mbështetje Aktivitetit për zhvillimin e modaliteteve për përcjelljen e pajtueshmërisë së raporteve të inspektimit, aprovimin dhe sigurimin e zbatimit të tyre përkatës.
- Aprovimi dhe zbatimi i Planit për Përmirësim të Shërbimeve të zhvilluar dhe bashkë-dizajnuar nga Aktiviteti, AKK, ZKK dhe organizatat e shoqërisë civile;
- Monitorimi i zbatimit të udhëzuesit për ulje të sjelljes diskriminuese në mënyrë që të përmirësohet me barazi ofrimi i shërbimeve të zhvilluara nga Aktiviteti dhe të aprovuara nga Komiteti për Praktika të Mira;
- Krijimi i Këshillit Publiko-Privat (KPP) dhe zhvillimi i diskutimeve dhe konsultimeve të rregullta;

- Kryerja e konsultimeve të KPP-së në mënyrë që të ndihmohen bizneset lokale t'i shprehin interesat dhe nevojat e tyre për tokë dhe që këto të përafrohen me caqet zhvillimore të PZHK-ve;
Sigurimi i pjesëmarrjes së bizneseve në përgatitjen e inventarit të tokave dhe asetëve të Komunës;
- Inkurajimi i bashkëpunimit në kohën e duhur të stafit të Komunës për plotësimin e aktiviteteve të kërkuara, duke siguruar qasje në të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar.

5. KOORDINIMI DHE KONSULTIMI:

Pjesëmarrësit planifikojnë t'i japin njëri-tjetrit informacionin e nevojshëm për të lehtësuar asistencën dhe për të vlerësuar efektshmërinë e asistencës. Pjesëmarrësit planifikojnë të kërkojnë të takohen periodikisht për shqyrtimin e mbështetjes dhe për ndarje të informatave relevante. Pjesëmarrësit planifikojnë ta zgjidhin me konsultim çdo çështje të mundshme në lidhje me interpretimin, administrimin ose zbatimin e këtij MM-je.

6. NJOFTIMET

Pjesëmarrësit synojnë që të gjitha njoftimet ose komunikimet në kuadër të këtij MM të jenë me shkrim, të dërgohen me e-mail dhe të adresohen si më poshtë.

Pikat e kontaktit për organizatat përkatëse janë:

Për Tetra Tech ARD, Inc.

Ramadan Klisurica

Zëvendës drejtor

Rr. Tirana "Prime Residence" C4/2, No.14 • 10000 Prishtina, Kosovë

ramadan.klisurica@tetratech.com

Për Komunën

Nita Efendia

Shefe e Kabinetit të Kryetarit

Rr. Nëna Tereze, 50,000 Gjakovë

nita.efendia@rks-gov.net

Secili Pjesëmarrës mund të ndryshojë pikën e saj të kontaktit duke i dërguar njoftim me shkrim Pjesëmarrësit tjetër.

7. PARIMET UDHËZUESE

Efekt i MM. Pjesëmarrësit pranojnë se ky MM nuk është traktat dhe nuk krijon të drejta ose detyrime sipas ligjit ndërkombëtar dhe se ky MM nuk përbën obligim për fonde dhe nuk ka për qëllim të përbëjë një zotim ligjërish të detyrueshëm nga ndonjë Pjesëmarrës apo të krijojë ndonjë të drejtë për ndonjë palë të tretë. Bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve, siç përshkruhet në këtë MM, nuk synon të krijojë një partneritet juridik ose lloj tjetër të subjektit ose personalitetit juridik. Secili Pjesëmarrës synon të pranojë përgjegjësinë e plotë dhe të vetme për secilin dhe të gjitha


shpenzimet e bëra nga ai vetë në lidhje me këtë MM. Pjesëmarrësit synojnë të mbajnë misionet dhe mandatet e tyre të veçanta dhe unike dhe llogaridhëniet e tyre. Ky Memorandum i Mirëkuptimit nuk e ka për qëllim të zëvendësojë çfarëdo marrëveshjeje ose kontrate të lidhur ndërmjet Pjesëmarrësve, apo të ndërhyjë në çfarëdo mënyre në to, qoftë para ose pas nënshkrimit të këtij MM. Asgjë në këtë MM nuk synon të krijojë një marrëdhënie ekskluzive pune.

Publiciteti. Pjesëmarrësit e kuptojnë se secili Pjesëmarrës mund ta bëjë publike ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij MM, duke përfshirë njoftimin për shtyp, komentit publik ose mjete të tjera për shpalosje, në përputhje me politikën dhe procedurat e veta. Aktiviteti pritet të sigurojë pajtueshmërinë me çdo kërkesë lidhur me përdorimin e llogos së USAID-it, brendimin dhe vendosjen e llogos sipas kushteve të kontratës së saj me USAID-in.

- A. Modifikimi.** Ky MM mund të modifikohet me shkrim nga Pjesëmarrësit. Secili Pjesëmarrës mund të tërhiqet nga ky MM duke i dërguar Pjesëmarrësit tjetër njoftim paraprak 30 ditore me shkrim.
- B. Kohëzgjatja.** Ky MM fillon në datën e nënshkrimit nga Pjesëmarrësit dhe vazhdon deri më 30 prill 2027. Ky MM mund të zgjatet me shkrim, me nënshkrimin nga të dy Pjesëmarrësit për çdo periudhë kohore. Secili Pjesëmarrës mund të tërhiqet nga ky MM duke i dërguar Pjesëmarrësit tjetër njoftim paraprak me shkrim një (1) muaj përpara tërheqjes.
- C. Përfaqësuesit.** Pjesëmarrësit synojnë që secili Pjesëmarrës të përfaqësohet nga bartësit ose ushtruesit e detyrave të nënshkruesve të këtij MM. Secili Pjesëmarrës, me anë të njoftimit me shkrim për tjetrin, mund të identifikojë përfaqësues shtesë të autorizuar për ta përfaqësuar atë Pjesëmarrës për të gjitha qëllimet, përveç modifikimeve të këtij MM. Secili Pjesëmarrës do ta njoftojë me shkrim tjetrin për ndryshimet e përfaqësuesve të autorizuar.
- D. Gjuha.** Ky MM është përgatitur në tri gjuhë: angleze, shqipe, dhe serbe.

Pjesëmarrësit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të vet të autorizuar siç duhet, kanë bërë të mundur që ky MM të nënshkruhet prej tyre dhe të dorëzohet më **10 korrik 2023**.

Për Tetra Tech ARD, Inc.



Emri: Jennifer Ober

Titulli: Drejtore e Aktivitetit

Data: 10 korrik 2023

Për Komunën e Gjakovës



Emri: Ardian Gjini

Titulli: Kryetar i Komunës

Data: 10 korrik 2023



Komuna e Gjakovës
Opština Đakovica-Municipality of Gjakova/Đakovica



MEMORANDUM OF UNDERSTANDING

BETWEEN

Tetra Tech ARD, Inc.
Implementor of the USAID Property Governance Activity

AND

Municipality of Gjakova/Đakovica

REGARDING THE
Joint Implementation of the Property Governance Activity

This Memorandum of Understanding ("MOU") is entered into this July 10, 2023 ("Effective Date"), by and between Tetra Tech ARD, Inc., and Municipality of Gjakova/Đakovica, collectively, referred to as the "Participants" and each singularly as the "Participant."

It is the goal of the USAID Property Governance Activity (hereafter the "Activity") to collaborate with the Municipality of Gjakova/Đakovica to improve the property rights system in Kosovo to reduce corruption, increase women's empowerment, and improve formal property rights and investments in real property.

It is the objective of the Activity to collaborate with Municipality of Gjakova/Đakovica to increase formal property rights by standardizing processes and practices in municipality;

It is the objective of Activity to collaborate with Municipality of Gjakova/Đakovica to increase civil society and citizen active engagement with institutions regarding property rights; and

It is the objective of the Activity to collaborate with Municipality of Gjakova/Đakovica to engage the private sector to strengthen Kosovo's property rights regime.

The Participants intend to jointly collaborate on the following activities:

1. PURPOSE

The purpose of this Memorandum of Understanding (MOU) is to formalize a collaboration between Tetra Tech ARD Inc., the contractor implementing the USAID-funded Kosovo Property Governance Activity and Municipality of Gjakova/Đakovica. By closely coordinating the efforts of the Activity and Municipality under this MOU, both parties intend to leverage their respective resources to achieve impacts that could not be achieved individually. The Activity and Municipality are committed to the principles of good governance: rule of law, transparency, accountability, efficiency, effectiveness, responsiveness, inclusion, and citizen participation. Accordingly, the Participants have signed this MOU to set forth their proposed actions with respect to their support of this purpose.

2. BACKGROUND

United States Agency for International Development (USAID) contracted Tetra Tech ARD, Inc. as the prime contractor to implement the five-year, \$10.1 million Kosovo Property Governance Activity. Tetra Tech ARD, Inc. will implement the Activity over a five-year period from May 2022 to May 2027. The Activity aims to improve the property rights system in Kosovo to reduce corruption, increase women's empowerment, and improve formal property rights and investments in real property. The Activity, in partnership with the civil society, the private sector, and other local actors will contribute to advancing locally led development.

The Activity will focus on strengthening the property rights system by improving Municipal Cadaster Office (MCO) processes and delivery of services citizens require to formalize and register their rights. The Activity will work on the standardization of administrative procedures that will incentivize citizens to initiate formalization proceedings and remove burdensome registration requirements that discourage citizens from registering their rights.

Expected results:

- Improved municipal capacities for property management;
- Improved processes and practices for building inspections that will contribute to increasing registered properties (ownership certificates) in selected municipalities;
- Unified/standardized service delivery of property-related services in selected municipalities;
- Integrate gender equality throughout Kosovo's property reforms, and
- Improved property inheritance processes.

In addition, the Activity will help mobilize citizen participation with the government to improve property processes and service delivery and inform municipal development plans (MDPs) in coordination with Local Councils. The Activity will assist the property transparency forums comprising civil society organizations, the private sector, journalists, and concerned citizens to oversee, monitor, and report on implementation of MDPs. These interventions will cumulatively facilitate a citizen-centered approach to property rights governance, strengthen the rapport between government and citizens, and increase transparency, accountability, and self-reliance.

Expected results:

- Strengthened civil society and citizen oversight in ensuring transparency, accountability, and efficiency in property rights and inheritance processes and services;
- Increased civil society participation in MDPs to ensure transparency in municipal property and land use;
- Increased awareness and advocacy about the value of women's property rights and inheritance to improve their economic opportunities; and
- Increased public's understanding of property sector rules and regulations to improve the public's advocacy to ensure access to services and protection of their property rights.

Finally, the Activity will work with the partnerships between the private sector, local government, and civil society and support reforms that will facilitate citizen's access to cadastral data, address constraints to formalize rights in newly constructed buildings and help demonstrate the business case for women to participate in the economy to help generate demand for inheritance proceedings. These partnerships will also introduce innovative approaches to new technologies that will strengthen public participation and enable increased transparency and accountability in the governance of property systems.

Expected results:

- Increased private sector engagement in institutional modernization and automatization technologies of property systems and services; and
- Increased private sector engagement on municipal development plans for more transparent property regulations and incentivize private sector investments.

Areas of Planned Technical Assistance

USAID's Property Governance Activity, implemented by Tetra Tech ARD, Inc., intends to address the needs of the municipality following interviews with municipal staff and a baseline survey to be performed by the Activity. The specific assistance planned to be provided by Tetra Tech ARD, Inc. in its implementation of the Activity specified below in section 4.

3. PROPERTY GOVERNANCE ACTIVITY'S PLANNED ROLE

The Activity intends to support municipality through focusing on the overall property governance goals in Kosovo, as follows:

- Assess, identify, and draft a report for the municipality with recommendations for harmonizing its regulatory framework with the registration laws.
- Develop a policy paper describing options for creating incentives to encourage citizens to register and formalize their rights;
- Draft guidelines for licensed private companies/individuals to carry out building inspections in a compliant manner;
- Provide trainings to licensed private companies/individuals based on approved guidelines;
- Organize a technical workshop between Inspection Units (IUs) and Association of Builders and Manufacturers of Construction Materials (ABMCM) to formulate outreach and information dissemination to investors/builders to help strengthen their compliance with construction and occupancy certificate issuance requirements;
- Develop modalities for tracking compliant inspection reports that enable registration of property rights;
- Draft assessment reports of technical capacities of Municipal Cadastral Office (MCO) and assessment reports identifying any bias in service delivery in MCO;
- Develop Service Delivery Improvement Plan through co-design processes with Kosovo Cadastral Agency (KCA) representatives, MCO staff and local CSO representatives;
- Facilitate formation of Property Transparency Forums (PTFs), in coordination with Local Councils to comprise a broad representation of citizen and private sector actors to monitor implementation of Municipal Development Plan (MDP);
- Organize Focus Group Discussions (FGDs) with municipal decision-makers and staff to inform and utilize measures to mitigate opportunities for corruption related to property services;

- Develop an anti-corruption training program for MCO and other municipal staff to help prevent corruption related to property services;
- Establish Property Transparency Forum;
- Coordinate with PTF to monitor implementation of MDP to increase transparency and accountability;
- Mobilize citizen participation in developing and monitoring MDP;
- Mobilize private sector engagement to improve the regulatory framework to increase transparency and create incentives for investment and to encourage Municipality to utilize GIS technologies to identify municipal land to be leased in compliance with MDPs for sustainable economic development;
- Assess Municipality's capacities to identify, map and manage information related to municipal owned land;
- Assist Municipality to conduct Public Private Council consultations to help local businesses express their interests and needs for land and align these with MDPs' development objectives, and
- Support Municipality to mobilize business participation in preparing municipality's inventory of land and assets.

4. MUNICIPALITY's PLANNED ROLE

The Municipality intends to:

- Approve and implement the recommendations for harmonizing municipal regulatory framework with the registration laws;
- Approve and supervise the implementation of recommended incentives to encourage citizens to register and formalize their rights;
- Implement the guidelines for licensed private companies/individuals to carry out building inspections in a compliant manner;
- Ensure that municipal staff take part in the workshops, trainings, focus group discussions and other activities provided by the Activity and its subcontractors;
- Provide support to the Activity for developing modalities for tracking compliance of inspection reports, approve and ensure their implementation, accordingly.
- Approve and implement the Service Delivery Improvement Plan developed and co-designed by the Activity, KCA, MCO and civil society organizations;
- Monitor the implementation of the guideline to reduce discriminatory behavior to equitably improve service delivery developed by the Activity and approved by Better Practices Committee;
- Establish Public Private Councils and conduct regular discussions and consultations;

- Conduct PPC consultations to help local businesses express their interests and needs for land and align these with MDPs' development objectives;
- Ensure business participation in preparing Municipality's inventory of land and assets;
- Encourage timely collaboration of Municipality of Gjakova/Đakovica staff in completing required activities, ensuring access to all the data and information required.

5. COORDINATION AND CONSULTATION:

The Participants plan to provide each other with the information needed to facilitate assistance and to evaluate the effectiveness of the assistance. The Participants plan to request to meet periodically to review assistance and share relevant information. The Participants plan to resolve any issues concerning the interpretation, administration, or implementation of this MOU by consultation between the Participants.

6. NOTICES

The Participants intend that all notices or communications under this MOU be in writing by email and addressed as follows.

The respective organizational points of contact are:

For Tetra Tech ARD, Inc.

Ramadan Klisurica

Deputy Chief of Party

Tirana Str. "Prime Residence" C4/2, No.14 • 10000 Pristina, Kosovo

ramadan.klisurica@tetrattech.com

For the Municipality of Gjakova/Đakovica

Nita Efendia

Chief of Cabinet

Nëna Tereze Str. 50,000 Gjakova/Đakovica

nita.efendia@rks-gov.net

Each Participant may change their point of contact by written notice to the other.

7. GUIDING PRINCIPLES:

Effect of MOU. The Participants recognize that this MOU is not a treaty and does not give rise to rights or obligations under international law, and that this MOU is not an obligation of funds and is not intended to constitute a legally binding commitment by any Participant or create any rights in any third party. The cooperation among the Participants as outlined in this MOU is not intended to create a legal partnership or other type of legal entity or personality. Each Participant intends to accept full and sole responsibility for any and all expenses incurred by

itself related to this MOU. The Participants intend to maintain their own separate and unique missions and mandates and their own accountabilities. This MOU is not intended to supersede or interfere in any way with any agreements or contracts entered into among the Participants, either prior to or subsequent to the signing of this MOU. Nothing in this MOU is intended to create an exclusive working relationship.

Publicity. The Participants understand that each Participant may make the existence and content of this MOU publicly available, including by press release, public commentary, or other means of disclosure, in accordance with its own policies and procedures. It is anticipated that the Activity will ensure compliance with any branding and marking requirements per the terms of its contract with USAID.

A. Modification. This MOU may be modified in writing by the Participants. Each Participant may withdraw from this MOU by giving the other Participant thirty (30) days written notice.

B. Duration. This MOU begins on the date of signature by the Participants and continues until April 30, 2027.

This MOU may be extended in writing signed by both Participants for any period of time.

Either Participant may withdraw from this MOU by providing one (1) month's written notice to the other Participant.


C. Representatives. The Participants intend that each Participant be represented by those holding or acting in the offices held by the signatories to this MOU. Each Participant may, by written notice to the other, identify additional representatives authorized to represent that Participant for all purposes other than modifications to this MOU. Each Participant is to notify the other in writing of changes in the authorized representatives.

D. Language. This MOU is prepared in English, Albanian, and Serbian.

The Participants, each acting through its duly authorized representative, have caused this MOU to be signed in their names and delivered as of **July 10, 2023**.

For Tetra Tech ARD, Inc.

**For Municipality of
Gjakova/Đakovica**


Name: Jennifer Ober

Title: Chief of Party

Date: July 10, 2023


Name: Ardian Gjini

Title: Mayor

Date: July 10, 2023